



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës  
SENATI AKADEMIK

Nr. 867 Prot.

Durrës, më 26.5.2022

**VENDIM**

Nr. 42, datë 26.5.2022

**PËR**

**"DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E DEKANATIT NR.22/1 DATË 17.05.2022, PËR APLIKIMIN NË PROGRAMIN E STUDIMIT "BIZNES DHE FINANCË", NË CIKLIN E TRETË TË STUDIMEVE MASTER EKZEKUTIV, NË FAKULTETIN E BIZNESIT, TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës"**

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr. 41 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar me VKM Nr.879, datë 16.12.2019 "Disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" në Udhëzimin Nr.01, datë 14.01.2020, "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, Shkresës së Njesisë Kryesore Nr. 271/1Prot., datë 17.05.2022, Shkresës nr. 290 prot datë 25.05.2022, Senati Akademik,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e ndryshimit të tarifës së studimit nga 150 000 Lekë në 120 000 Lekë të programit të studimit Master Ekzekutiv në "Biznes dhe Financë", ofruar pranë Fakultetit të Biznesit.
2. Miratimin e shfuqizimit të pikës Nr.5 së Vendimit të Dekanatit datë 09.05.2022 ku parashikohej: *"Dorëzimi i një dokumenti "shprehje interesi" nga stafi akademik i jashtëm që do të angazhohen në programin, Master Ekzekutiv "Biznes dhe Financë", të cilët pranojnë të angazhohen në këtë program"*.
3. Ky vendim i përcillet për shqyrtim Bordit të Administrimit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
  - ✓ Zv. Rektorët
  - ✓ Drejtuesi i Njesisë Kryesore të Fakultetit të Biznesit
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R**

**Prof. Dr. Kseanela SOTIROFSKI**

